

VENDIM
Nr. 67, datë 3.6.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fiona Papajorgji	kryetare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Illir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Asim Vokshi	anëtar;
Marsida Xhaferllari	anëtare,

me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 3.6.2026, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 26 (S) 2025 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Skënder Krasniqi, përfaqësuar nga avokatët e zgjedhur Zaçe Islami dhe Toto Avdiaj.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Prokuroria e Përgjithshme, përfaqësuar nga prokurori Arqilea Koça, me autorizim.

Trashëgimtarët e Viktimës: Naime Likometaj, Selman Likometaj, Florije Hajdari, Valentina Meçaj, Vero Likometaj, Viktor Likometaj, Agim (Nikita) Likometaj, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 62-2022-2007 (205), datë 25.5.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; nr. 10, datë 18.1.2023, të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00-2025-1194, datë 17.7.2025, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 18, pika 1, 29, pikat 2 dhe 3, 34, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, pikat 1 dhe 2, 71, pika 1, 71/a dhe 71/b, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuarit Skënder Krasniqi (*kërkuesi*), që ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjekteve të tjera të interesuara, trashëgimtarëve të viktimës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier (*Prokuroria e Fierit*), me vendimin e datës 23.11.2015, mbi bazën e materialeve të përcjella nga Drejtoria Vendore e Policisë Fier, ka filluar procedimin penal ndaj kërkuesit, si person i dyshuar për kryerjen e veprave penale të vrasjes me paramendim të një shtetasi 82-vjeçar, të ndodhur një ditë më parë (22.11.2015), si dhe të mbajtjes pa leje të armëve të ftohta, të parashikuara nga nenet 78 dhe 279 të Kodit Penal (KP).

2. Gjatë fazës së hetimeve paraprake, ndaj kërkuesit është caktuar masa e sigurimit “Arresti në burg”, e cila, me vendimin e datës 31.7.2016, është zëvendësuar me masën “Ndalimi i daljes jashtë shtetit”. Më pas, me vendimin e datës 20.11.2016, Prokuroria e Fierit, bazuar në nenin 328, pika 1, shkronja “dh”, të Kodit të Procedurës Penale (KPP), sipas formulimit në fuqi në atë kohë, ka vendosur pushimin e ndjekjes penale ndaj kërkuesit, me arsyetimin se nga hetimet e zhvilluara rezultonte se veprat penale nuk ishin kryer nga ai.

3. Në vijim, me vendimin e datës 30.5.2018, Prokuroria e Fierit ka vendosur pezullimin e hetimeve, duke arsyetuar se, megjithëse ishin kryer një sërë veprimesh hetimore, nuk ishte bërë i mundur identifikimi i autorëve të veprës penale. Pas ankimit të trashëgimtarëve të viktimës, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin e datës 20.3.2019, ka shfuqizuar këtë vendim, duke vlerësuar se prokurori nuk ka kryer të gjitha veprimet hetimore të mundshme. Në zbatim të këtij vendimi gjyqësor, Prokuroria e Fierit ka rifilluar hetimet në datën 5.7.2019.

4. Në datën 15.10.2020, gjyqtari i hetimeve paraprake ka pranuar kërkesën e Prokurorisë së Fierit për revokimin e vendimit të pushimit të procedimit penal ndaj kërkuesit dhe caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg”. Sipas këtij vendimi, dyshimi i arsyeshëm mbështetej, ndër të tjera, në përmbajtjen e transkriptimit të përgjimeve ambientale të zhvilluara midis kërkuesit dhe nënës së tij në datën 23.11.2015, të vlerësuar në harmoni me tërësinë e provave dhe të rezultateve të hetimeve.

5. Më pas, në datën 20.4.2021, pra më shumë se pesë vjet pas ngjarjes, Prokuroria e Fierit ka vendosur marrjen e kërkuesit si të pandehur, duke e akuzuar për kryerjen, në bashkëpunim, të veprës penale “Vrasja me paramendim”, të parashikuar nga nenet 78, paragrafi i parë, dhe 25 të KP-së. Në vijim, me vendimin e datës 7.6.2021, gjyqtari i seancës paraprake ka pranuar kërkesën e prokurorisë dhe ka vendosur dërgimin e çështjes për gjykim në themel.

6. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. 62-2022-2007 (205), datë 25.5.2022, ka deklaruar kërkuesin fajtor për kryerjen e veprës penale “Vrasja me paramendim”, të parashikuar nga neni 78, paragrafi i parë, i KP-së, duke e dënuar me 20 vjet burgim. Sipas asaj gjykate, nga provat e administruara është krijuar bindja, përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, se kërkuesi ka kryer vrasjen për motive të dobëta, të lidhura me ngacmimet që viktima i kishte bërë nënës së tij. Nga ana tjetër, gjykata ka vlerësuar se nuk provohej ekzistenca e bashkëpunimit në kryerjen e veprës penale.

7. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim, por Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 10, datë 18.1.2023, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke ndarë të njëjtin arsyetim për vlerësimin e provave dhe përgjegjësinë penale të kërkuesit. Edhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-1194, datë 17.7.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se ai nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara në nenin 432 të KPP-së.

8. Në datën 15.10.2025 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili pasi është plotësuar sipas parashikimeve të Ligjit Organik të Gjykatës është regjistruar në datë 22.10.2025. Me vendimin e datës 29.12.2025, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e

cila, me vendimin e datës 16.1.2026, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

9. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se nga vendimet e kundërshtuara i janë cenuar:

9.1 *Parimi i prezumimit të pafajësisë*, i garantuar nga neni 30 i Kushtetutës, pasi gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është provuar se ai është autor i veprës penale për të cilën është dënuar. Gjykatat kanë dhënë një vendim arbitrar, duke e deklaruar fajtor atë për veprën penale të vrasjes me paramendim dhe dënuar me 20 vjet burgim, pa administruar asnjë provë të drejtpërdrejtë që të vërtetonte fajësinë e tij. Fillimisht, prokuroria ka vendosur pushimin e procedimit penal dhe lirim të kërkuarit, me arsyetimin se nuk provohej përfshirja e tij në ngjarje, ndërsa disa vite më vonë procedimi është rihapur në rrethana të paqarta dhe mbi bazën e veprimeve hetimore të sajura. Gjykatat e kanë mbështetur fajësinë vetëm në indicie të dyshimta dhe në transkriptimet e përgjimeve ambientale, të cilat nuk përbëjnë provë. Organet e procedimit nuk kanë zhvilluar një hetim të plotë dhe të gjithanshëm, pasi nuk kanë ndjekur pista të tjera hetimore, përfshirë dyshimet e ngritura nga trashëgimtarët e viktimës për vjedhjen e një shume parash si motiv i mundshëm i vrasjes, duke mos zbardhur në mënyrë të plotë të gjitha rrethanat e çështjes.

9.2 *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

9.2.1 *Parimi i barazisë së armëve*, pasi gjykatat kanë refuzuar me pa të drejtë kërkesat e mbrojtjes për administrimin e provave që ishin në favor të kërkuarit, duke e vendosur atë në pozitë të pafavorshme përballë akuzës. Konkretisht, është rrëzuar kërkesa për ritranskriptimin e bisedave të përgjuara nga një grup specialistësh, me qëllim verifikimin e saktësisë së regjistrimit për një segment prej 54 sekondash, si dhe kërkesa për kryerjen e një ekspertimi daktiloskopik, për të krahasuar gjurmët e gishtërinjve të gjetura në vendngjarje. Gjithashtu, gjykatat e kanë bazuar vendimin në deklaratime të dhëna përpara policisë dhe jo në ato të bëra përpara gjykatës, duke u dhënë atyre një kuptim në favor të akuzës.

9.2.2 *Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykatat nuk kanë arsyetuar çështjen, por çdo gjë e thënë prej tyre nuk ka dalë gjatë shqyrtimit gjyqësor. Vendimet janë kontradiktore dhe nuk bazohen në dispozitat procedurale penale.

10. **Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se pretendimet janë haptazi të pabazuara, pasi:

10.1 Gjatë procedimit penal ndaj kërkuarit është respektuar *parimi i prezumimit të pafajësisë*. Vendimet e gjykatave të zakonshme nuk paraqesin asnjë element arbitrar, sepse ato janë mbështetur në një vlerësim të plotë dhe të gjithanshëm të provave, në përputhje me ligjin, ndërsa kërkuarit i është garantuar mundësia të paraqesë dhe të mbrojë të gjitha pretendimet e tij, edhe pse ato nuk janë pranuar nga gjykatat. Vlerësimi i fakteve dhe i provave përbën atribut ekskluziv të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe, në rastin konkret, ato kanë arritur në përfundimin se fajësia e kërkuarit është provuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Vendimi i dënimit është mbështetur në një analizë të harmonizuar të të gjitha provave të administruara, përfshirë deklaratimet e familjarëve dhe dëshmitarëve të tjerë, provat shkencore dhe përgjimet ambientale, të cilat janë vlerësuar në përputhje me rregullat e logjikës dhe në lidhje me njëra-tjetrën. Përgjimet janë

autorizuar mbi bazën e një dyshimi të arsyeshëm, janë përftuar në përputhje me procedurat ligjore dhe, për rrjedhojë, përbëjnë prova të ligjshme.

10.2 *E drejta për proces të rregull ligjor* është respektuar, pasi:

10.2.1 Pretendimi për cenimin e *parimit të barazisë së armëve* është i pabazuar. Gjykimi në shkallë të parë dhe në apel është zhvilluar në seancë publike, në prani të kërkuesit dhe mbrojtësit të tij, të cilët kanë pasur mundësi të njihen me të gjitha provat e administruara dhe të ushtrojnë efektivisht të drejtat e mbrojtjes. Kërkuesi nuk ka treguar se ku qëndron parregullsia procedurale e pretenduar, ndërsa të gjitha kërkesat e mbrojtjes, përfshirë ato për kryerjen e ekspertimeve shtesë ose ritranskriptimin e përgjimeve, janë shqyrtuar dhe janë vlerësuar në përputhje me ligjin. Pretendimet e kërkuesit mbështeten në interpretimin e tij të deklarimeve të dhëna jashtë gjykatës dhe në një paraqitje të deformuar të fjalëve të dëshmitarëve, ndërkohë që nuk rezulton të ketë pasur ndryshime të pajustificuara midis deklarimeve të dhëna gjatë hetimit paraprak dhe atyre të bëra në seancën gjyqësore, por vetëm qëndrime të ndryshme të palëve lidhur me vlerësimin e provave.

10.2.2 Pretendimi për cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor* është i pabazuar. Gjykatat e zakonshme kanë arsyetuar në mënyrë të plotë dhe të detajuar vendimmarrjen e tyre, duke adresuar të gjitha pretendimet e paraqitura nga mbrojtja e kërkuesit. Pretendimi për gabime në vlerësimin e dëshmive ose për anashkalimin e provave shkencore dhe telekomunikuese nuk qëndron, pasi edhe këto prova janë analizuar dhe vlerësuar në tërësinë e tyre.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

11. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

12. Duke pasur parasysh natyrën kumulative të kriterëve të legjitimitimit dhe jurisprudencën e saj, Gjykata vëren se kriteret *ratione personae*, *shterimi i mjeteve juridike efektive* dhe *ratione temporis* janë të përmbushura. Në lidhje me to, nuk rezulton të ketë çështje që kërkojnë analizë të mëtejshme, ndërsa as subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, nuk ka ngritur ndonjë prapësim.

13. Në drejtim të legjitimitimit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e *parimit të prezumimit të pafajësisë* dhe *së drejtës për proces të rregullt ligjor*, në aspektet e parimit të *barazisë së armëve* dhe të *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, të garantuara nga nenet 30 dhe 42 të Kushtetutës. Ai kundërshton mënyrën sesi gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë arritur në përfundimin për fajësinë e tij, duke pretenduar se vendimi i dënimit është mbështetur vetëm në transkriptimet e përgjimeve ambientale dhe në dëshmi kontradiktore, pa prova të mjaftueshme, si dhe se janë rrëzuar të gjitha kërkesat e mbrojtjes për administrimin e provave në favor të tij.

14. Gjykata vëren se, në pamje të parë, këto pretendime duket se lidhen me mënyrën e vlerësimit të provave nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, çështje, e cila, si rregull, nuk bën pjesë në

juridiksionin kushtetues. Megjithatë, në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se kur kërkuesi vë në dyshim mënyrën e vlerësimit të provave nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, duke pretenduar sesi pasojë e saj i është cenuar e drejta për t'u prezumuar i pafajshëm, kontrolli i këtij vlerësimi hyn në juridiksionin e Gjykatës (*shih vendimet nr. 45, datë 2.4.2026; nr. 26, datë 29.4.2025; nr. 63, datë 20.11.2023, të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin konkret, Gjykata çmon se, pavarësisht mënyrës së formulimit të tyre, pretendimet e kërkuesit kanë të bëjnë, në thelb, me respektimin e *parimit të prezumimit të pafajësisë*, të garantuar nga neni 30 i Kushtetutës. Për rrjedhojë, ndryshe nga sa prapëson subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ato bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues të Gjykatës dhe do të shqyrtohen në vijim në këndvështrim të këtij parimi.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë

15. Kërkuesi ka parashtruar se gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është provuar se ai është autor i veprës penale dhe se gjykatat e kanë deklaruar fajtor në mënyrë arbitrare, pa u mbështetur në prova të mjaftueshme. Sipas tij, vendimi i dënimit me 20 vjet burgim është bazuar në transkriptimet e përgjimeve ambientale, të cilat nuk përbëjnë provë në vetvete, ndërsa provat shkencore nuk kanë konfirmuar përfshirjen e tij në ngjarje. Ai ka pretenduar gjithashtu se hetimi ka qenë i paplotë, pasi janë rrëzuar pa të drejtë kërkesat e mbrojtjes për ritranskriptimin e përgjimeve, për krahasimin daktiloskopik të gjurmëve të gjetura në vendngjarje dhe për përjashtimin e bisedave të transkriptuara nga provat. Sipas kërkuesit, gjykatat kanë bërë një lidhje të pabazuar midis përgjimeve dhe ngjarjes, janë mbështetur në deklarime të dhëna përpara policisë në vend të atyre të dhëna në gjykatë, dhe nuk kanë dhënë një arsyetim të plotë e të bazuar në dispozitat procedurale penale.

16. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se gjatë gjykimit të kërkuesit janë respektuar të gjitha garancitë procedurale dhe se vendimet e gjykatave nuk paraqesin asnjë element arbitrar. Sipas saj, fajësia e kërkuesit është provuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm mbi bazën e një vlerësimi të gjithanshëm të provave, përfshirë dëshmitë, provat shkencore dhe përgjimet ambientale, të cilat janë përfutur dhe administruar në përputhje me ligjin. Gjithashtu, Prokuroria e Përgjithshme ka prapësuar se mbrojtjes i është garantuar ushtrimi i të gjitha të drejtave procedurale, ndërsa gjykatat kanë shqyrtuar dhe kanë arsyetuar në mënyrë të plotë çdo pretendim të paraqitur prej saj.

17. Neni 30 i Kushtetutës parashikon se kushdo quhet i pafajshëm derisa fajësia e tij të provohet me vendim gjyqësor të formës së prerë. Ky parim është pasqyruar edhe në nenin 4 të KPP-së, sipas të cilit çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit.

18. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka theksuar se prezumimi i pafajësisë nënkupton se barra e provës i takon akuzës, gjykata nuk mund ta nisë gjykimin me bindjen se i pandehuri është fajtor dhe vendimi i dënimit duhet të mbështetet në prova të mjaftueshme që provojnë fajësinë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, pa u bazuar në aludime ose dyshime (*shih vendimet nr. 63, datë 20.11.2023; nr. 10, datë 12.4.2022; nr. 68, datë 14.11.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Gjykata ka pohuar gjithashtu se, megjithëse prezumimet ligjore ose të faktit nuk janë të ndaluara në procesin penal, ato duhet të qëndrojnë brenda kufijve të arsyeshëm dhe të mos cenojnë të drejtat e mbrojtjes. Po kështu, ajo ka theksuar se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese u përket, në radhë të parë, gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, në zbatim të parimit të subsidiaritetit dhe të detyrimit kushtetues të organeve publike për të respektuar të drejtat dhe liritë themelore (*shih vendimin nr. 63, datë 20.11.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në dritën e standardeve të mësipërme, Gjykata do të verifikojë nëse në çështjen konkrete gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë përdorur prezumime fakti që tejkalojnë kufijtë e arsyeshem ose që kanë cenuar të drejtat e mbrojtjes, në kundërshtim me parimin e prezumimit të pafajësisë. Duke pasur parasysh se ky kontroll nuk konsiston në një rivlerësim të provave, por në verifikimin e respektimit të garancive kushtetuese, Gjykata do ta mbështesë analizën e saj në arsyetimin e vendimeve gjyqësore, për të vlerësuar nëse përfundimet e arritura prej tyre janë në përputhje me standardet kushtetuese.

21. Nga aktet e dosjes gjyqësore rezulton se, me vendimin e datës 23.11.2015, Prokuroria e Fierit lejoi përgjimin e menjëhershëm të bisedës ndërmjet kërkuesit dhe nënës së tij në ambientet e policisë, vendim i cili u vleftësua si i ligjshëm nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier një ditë më pas. Pas transkriptimit të kësaj bisede dhe kryerjes së veprimeve të tjera hetimore, prokuroria vlerësoi se dyshimet ndaj kërkuesit ishin zbehur, kërkoi zëvendësimin e masës së sigurimit të arrestit në burg me masën e ndalimit të daljes jashtë shtetit dhe, më pas, me vendimin e datës 30.5.2018, vendosi pezullimin e hetimeve, pasi nuk ishte bërë i mundur identifikimi i autorit të veprës penale.

22. Pas ankimit të trashëgimtarëve të viktimës, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier urdhëroi rifillimin e hetimeve dhe përcaktoi veprimet hetimore që duhej të kryheshin. Në zbatim të këtij vendimi, prokuroria rifilloi hetimet dhe, me urdhrin e datës 22.9.2020, vendosi ritranskriptimin e një pjese prej 54 sekondash të regjistrimit audio të bisedës së zhvilluar më 23.11.2015, ndërmjet kërkuesit dhe nënës së tij. Sipas kërkuesit, kjo pjesë nuk kishte rezultuar e kuptueshme në transkriptimin e parë, ndërsa në ritranskriptimin e dytë kishte marrë një përmbajtje të ndryshme. Për këtë arsye, ai kërkoi që ritranskriptimi të kryhej nga një grup specialistësh.

23. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier e rrëzoi këtë kërkesë me vendim të ndërmjetëm, duke e vlerësuar të panevojshme, me arsyetimin se procesverbalet e transkriptimit dhe të ritranskriptimit ishin administruar rregullisht gjatë hetimeve dhe se mbrojtja nuk kishte paraqitur shkaqe konkrete që të vinin në dyshim vlefshmërinë ose besueshmërinë e tyre. Sipas saj, pavarësisht ndryshimeve të pretenduara nga mbrojtja, përmbajtja thelbësore e bisedës mbetej e njëjtë dhe përputhej me provat e tjera të administruara në gjykim (*shih vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, faqet 36–38*).

24. Ky arsyetim u vlerësua i drejtë edhe nga Gjykata e Apelit Vlorë, e cila çmoi se prokuroria kishte paraqitur një tërësi provash bindëse që provonin fajësinë e kërkuesit. Në këtë kuadër, ajo i kushtoi rëndësi edhe përmbajtjes së përgjimit ambiantal të zhvilluar ndërmjet kërkuesit dhe nënës së tij, duke vlerësuar se ai përmbante elemente që mbështesnin përfundimin se autori i veprës penale ishte kërkuesi (*shih vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë, faqja 28*).

25. Edhe Gjykata e Lartë i vlerësoi të pabazuara pretendimet e rekursit lidhur me ritranskriptimin dhe ligjshmërinë e përgjimit, duke arsyetuar se këto çështje ishin trajtuar drejt dhe në mënyrë shteruese nga gjykata e apelit, dhe se përgjimi përfshirë transkriptimin e bërë me procesverbal nga oficeri i Policisë Gjyqësore ishin kryer në përputhje me kërkesat e KPP-së. Ajo e ka vlerësuar të pabazuar edhe pretendimin për paligjshmërinë e përgjimit, duke çmuar se lejimi i tij nga prokurori ishte në përputhje me nenin 222 të KPP-së, për shkak të dyshimit të arsyeshem dhe të urgjencës që impononte hetimi i një krimi të rëndë. Ndërsa, për sa i përket nivelit të provueshmërisë dhe fuqisë provuese të provave, ajo ka theksuar se rivlerësimi i tyre nuk hyn në juridiksionin e saj, por ka çmuar se gjykatat e faktit e kishin përmbushur standardin e provueshmërisë përtej çdo dyshimi të arsyeshem (*shih vendimin e Gjykatës së Lartë, paragrafët 20 dhe 21*).

26. Gjykata vëren se gjykatat e faktit e kanë deklaruar fajtor kërkuesin për veprën penale të vrasjes me paramendim, duke arritur në përfundimin se fajësia e tij provohej përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Sipas tyre, megjithëse nuk kishte prova të drejtpërdrejta, tërësia e provave të tërthorta krijonte një zinxhir logjik. Në këtë drejtim, ato janë mbështetur, ndër të tjera, në motivin e krimit të lidhur me ngacmimet e viktimës ndaj nënës dhe të bashkëshortes së kërkuesit, debatin e zhvilluar midis tyre pak përpara ngjarjes, përgjimet ambientale, deklaramet e dëshmitarëve, mungesën e një alibie për kohën e kryerjes së veprës dhe afërsinë e banesës së kërkuesit me atë të viktimës.

27. Mbi bazën e këtyre rrethanave, gjykatat kanë arritur në përfundimin, përmes prezumimeve faktike, se kërkuesi ishte autori i vrasjes së viktimës. Konkretisht, ato kanë prezumuar se ai kishte hyrë në banesën e viktimës, e kishte neutralizuar me goditje në pjesë të ndryshme të trupit, e kishte mbështjellë me një çarçaf, e kishte transportuar pranë një koshi mbeturinash dhe i kishte prerë fytin me thikë, duke i shkaktuar vdekjen. Në të njëjtën linjë, ato kanë prezumuar se gjurma e gjakut të viktimës, e konstatuar në derën e banesës, ishte lënë nga kërkuesi gjatë largimit nga vendi i ngjarjes. Gjithashtu, në arsyetimin e tyre gjykatat kanë marrë në konsideratë edhe moshën e viktimës dhe të kërkuesit, duke arritur në përfundimin se vrasja ishte planifikuar dhe kryer me paramendim për motive të dobëta.

28. Gjykata thekson se analiza e saj nuk ka për objekt të vërë në dyshim faktin penal të vrasjes së viktimës, por të verifikojë nëse përfundimi i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për fajësinë e kërkuesit është arritur në përputhje me garancitë që burojnë nga *parimi i prezumimit të pafajësisë*. Në këtë këndvështrim, ajo vëren se gjykatat e faktit kanë ndërtuar arsyetimin e tyre kryesisht mbi ekzistencën e motivit të dobët dhe, mbi këtë bazë, kanë rindërtuar me hollësi mekanizmin e kryerjes së veprës penale dhe veprimet konkrete të kërkuesit. Megjithatë, nga arsyetimi i vendimeve nuk rezulton të jetë analizuar ndonjë provë e drejtpërdrejtë ose rrethanore që të hidhte dritë konkretisht për kryerjen e këtyre veprimeve prej tij.

29. Në veçanti, Gjykata vëren se elementi kryesor mbi të cilin janë mbështetur gjykatat është transkriptimi i përgjimit ambiental të zhvilluar ndërmjet kërkuesit dhe nënës së tij. Ky transkript ka marrë vlerësime të ndryshme gjatë procedimit penal. Fillimisht, gjatë fazës së parë të hetimeve, përmbajtja e tij nuk është konsideruar e tillë që të provonte fajësinë e kërkuesit, aq sa prokuroria çmoi se dyshimet ndaj tij ishin zbehur, ndaj kërkoi zëvendësimin e masës së sigurimit personal dhe më pas vendosi pezullimin e hetimeve. Vetëm pas rifillimit të tyre dhe ritranskriptimit të së njëjtës pjesë të regjistrimit, pasi kishin kaluar pothuajse 5 vjet nga ngjarja, përmbajtja e bisedës u interpretua si element që mbështeste në mënyrë të tërthortë autorësinë e kërkuesit.

30. Ndërkohë, vetë gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë pranuar se transkriptimi i bisedës nuk përmban rrëfim ose përshkrim të veprimeve konkrete të kërkuesit në lidhje me vrasjen e viktimës. Përmbajtja e tij kufizohet në disa shprehje të përgjithshme, konkretisht në përgjigjen e kërkuesit se “e kishin mbajtur deri vonë” dhe në shprehjen “e hëngri atë fat”, pa ndonjë referim të drejtpërdrejtë për kryerjen e veprës penale ose mënyrën e realizimit të saj. Megjithatë, nga kjo përmbajtje, e vlerësuar së bashku me rrethanat e tjera të çështjes, gjykatat e faktit kanë nxjerrë prezumimin e faktit se kërkuesi ishte autori i vrasjes së viktimës (*shih paragrafët 23 dhe 24 të vendimit*).

31. Pavarësisht këtyre rrethanave, kërkesa e mbrojtjes që ritranskriptimi të kryhej nga një grup specialistësh, me qëllim verifikimin e besueshmërisë së këtij elementi provues, u refuzua nga gjykatat si e panevojshme. Në vlerësimin e Gjykatës, përderisa i njëjti regjistrim kishte prodhuar rezultate të ndryshme në faza të ndryshme të procedimit dhe kishte marrë rëndësi përcaktuese për autorësinë e veprës penale, verifikimi i kërkuar nga mbrojtja paraqitej i rëndësishëm për ushtrimin efektiv të së drejtës së saj për t’u mbrojtur. Nga ana tjetër, vlerësimi i gjykatave të faktit është

përligjur edhe nga Gjykata e Lartë. Ajo ka arsyetuar se çështja e nivelit të provueshmërisë dhe e vlerësimit të provës ishte trajtuar në përputhje me ligjin material e procedural penal (*shih paragrafin 25 të vendimit*).

32. Në këto kushte, Gjykata çmon se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë ndërtuar përfundimin për fajësinë e kërkuesit mbi prezumime fakti që tejkalojnë kufijtë e arsyeshëm të lejuar nga parimi i prezumimit të pafajësisë. Për më tepër, refuzimi i kërkesës së mbrojtjes për verifikimin e besueshmërisë së elementit kryesor provues ka cenuar të drejtat e mbrojtjes. Këto mangësi marrin rëndësi të veçantë, duke pasur parasysh se prezumimet e nxjerra kanë shërbyer si bazë për deklarinimin fajtor të kërkuesit dhe dënimin e tij me 20 vjet burgim.

33. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se mënyra sesi gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë arritur në përfundimin për fajësinë e kërkuesit ka cenuar parimin e prezumimit të pafajësisë, të garantuar nga neni 30 i Kushtetutës, ndaj pretendimi i tij është i bazuar.

34. Nisur nga ky vlerësim, Gjykata çmon se për shkak se riparimi i shkeljes kërkon rivlerësimin e fakteve dhe të provave të administruara gjatë hetimit, rihetimit dhe gjykimit, çështja duhet t'i dërgohet për rishqyrtim Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, në përputhje me kompetencën e saj lëndore. Kjo gjykatë, në ushtrim të kompetencave të saj si gjykatë ligji dhe fakti, është në pozicionin e duhur për të shqyrtuar pretendimet e kërkuesit dhe për t'u dhënë atyre përgjigje në respektim të standardeve kushtetuese, duke plotësuar mangësitë e konstatuara dhe riparuar shkeljet e kryera gjatë gjykimit në gjykatën e shkallës së parë.

35. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit janë të bazuara, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe nenit 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimeve nr. 00-2025-1194, datë 17.7.2025, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe nr. 10, datë 18.1.2023, të Gjykatës së Apelit Vlorë, si të papajtueshme me Kushtetutën.
3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.
Marrë më 3.6.2026.
Shpallur më 20.7.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji

Anëtarë: Sandër Beci, Sonila Bejtja, Marjana Semini, Genti Ibrahim, Ilir Toska, Marsida Xhaferllari, Asim Vokshi